MODELI EKONOMIK "POST-TRANZICION" DHE LLOJI I KAPITALIZMIT QË DUAM TË NDËRTOJMË

Prof.Asoc.Dr. Adrian CIVICI
Dr. Fatos IBRAHIMI
Prof.Asoc.Dr. Mimoza MANXHARI

The "Post – transition" economic model and the capitalism we want to have.

The current global financial crisis rather than its direct impact on the Albanian economy or finances, identified a major problems: how stable is our economic growth? Do we have the appropriate economic model to ensure the pace of this growth in the coming years? Do we have a structured economy with which to move towards a sustainable development of long-term? Assuming that the direct and indirect effects of the
International financial and economic crisis are one or several years, and then we have to face "with normality", we evaluate that this is our most important problem.

Bashkë me vitin 2010 duket se po shkojmë edhe drejt "mbylljes" së një cikli të rëndësishëm 20 vjeçar të tranzicionit. Kemi folur e jemi përpjekur shumë për vendosjen dhe performancën e ekonomisë së tregut në Shqipëri, kemi zbatuar me rigorozitet recetat e FMN-së dhe Bankës Botërore për privatizimin e ekonomisë dhe hapjen e saj, jemi treguar maksimalisht ortodoksë në çështjen e ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë, jemi fokusuar pothuajse plotësisht te rritja ekonomike si treguesi i vetëm i suksesit e performancës së politikave ekonomike e qeverisjes. Pra, me fjalë të tjera, kemi ndërtuar një model ekonomik të tranzicionit, një profil të vetë ekonomisë shqiptare që me të mirat dhe defektet e tij u bë "lokomotiva" që na tërhoqi deri në fund të dekadës së dytë të këtij tranzicioni radikal "nga plani tek tregu".

Por, duket se kohës dhe përmbajtjes së këtij modeli po i vjen fundi, në kuptimin që shumë nga elementët dhe energjitë e tij duket se e arritën maksimumin e tyre dhe tashmë rezultojnë të ezauruara për një periudhë tjetër 10 ose 20 vjeçare në të ardhmen. Kriza aktuale ekonomiko-financiare globale më shumë se sa ndikimi direkt

i saj në ekonominë apo financat shqiptare, na evidentoi dhe disa probleme kardinale: sa e qëndrueshme është rritja jonë ekonomike? A kemi modelin e përshtatshëm ekonomik për të garantuar ritmet e kësaj rritjeje në vitet që vijnë? A kemi një ekonomi të strukturuar me të cilën mund të shkojmë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë? Duke supozuar se efektet direkte e indirekte të krizës ekonomiko-financiare ndërkombëtare janë një ose disa vjeçare, dhe pastaj ne duhet të përballemi «me normalitetin», vlerësohet se pikërisht këtu qëndron problemi ynë më serioz. Vërtet që në 2008 dhe 209 ekonomia shqiptare mundi të ketë një rritje ekonomike më të ulët se trendi disa-vjeçar i saj, dhe kjo është «e justifikueshme» si pasojë e krizës globale, por pikëpyetjet e mëdha duket se fillojnë pikërisht pas kësaj periudhe.

Garantimi i rritjes së qëndrueshme nënkupton faktin se sa do të jemi ne në gjendje që të gjejmë e identifikojmë "*burime të reja që ushqejnë rritjen ekonomike*" apo dhe «*zëvendësuesit*» e disa prej burimeve aktuale të rritjes që në periudha afat-shkurtër e afat-mesme pritet të kontribuojnë shumë më pak se deri tani. Si do ta eliminojmë apo ngushtojmë deficitin e lartë tregtar dhe atë të pagesave? Si do ta ristrukturojmë hapësirën rurale shqiptare ku mbizotërojnë mini-fermat bujqësore? Si do ta zhvillojmë, ristrukturojmë e modernizojmë biznesin shqiptar që akoma reflekton mjaft elementë arkaikë e informalë? Cilat janë politikat më të mira strukturore që na konvergojnë me ekonominë evropiane ku synojmë të integrohemi? Cilët do jenë sektorët që do përbëjnë «motorin» e ekonomisë shqiptare në vitet në vazhdim? Turizmi? Bujqësia dhe agro-industria? Energjia? Industria? Infrastruktura? Arsimi? Ekonomia e dijes? Shërbimet? Zhvillimi i biznesit të vogël e të mesëm? etj. Duket se ka ardhur plotësisht koha që të jemi sa më të qartë në objektivat themelore të zhvillimit dhe modelit të rritjes për 10-20 vitet në vazhdim. Këtë mangësi e bën akoma më të rëndë edhe fakti se forcat kryesore politike janë në antagonizëm të vazhdueshëm ndërmjet tyre, antagonizëm që shprehet në qëndrimet mohuese të çdo arritjeje ekonomike reciproke dhe neglizhenca e dukshme ndaj konceptit të një «strategjie kombëtare të zhvillimit» të përgatitur me konsensusin maksimal politik e shkencor të nevojshëm dhe e respektuar nga të dyja palët.

Ndodhemi në një moment thelbësor për të diskutuar e precizuar një koncept e një politikë të qartë për modelin e rritjes ekonomike dhe faktorët esencialë të saj. Mbyllja e "periudhës 20 vjeçare të tranzicionit" si dhe kriza aktuale ekonomiko-financiare na ka vënë përballë një fakti të pakundërshtueshëm. Modeli i deritashëm garantues i rritjes ekonomike në Shqipëri i mbështetur kryesisht në të ardhurat nga emigracioni që në disa vite kanë qenë edhe më të larta se 1 miliard euro në vit, donacionet e shumta si vend i varfër dhe në zhvillim që kemi përfituar me shumicë, kreditë e buta dhe ndihmën e huaj që kanë qenë një arterie e rëndësishme që furnizonte rregullisht ekonominë tonë, privatizimet masive që i kanë krijuar buxheteve tona luksin e të qenit në ekuilibër dhe

me defiçit minimal, vetëpunësimi kryesisht bujqësor, "*boom*" mbi 15 vjeçar i sektorit të ndërtimit, shkarkimi i papunësisë nëpërmjet emigracionit drejt Greqisë apo Italisë, "rekomandimet detyruese" të FMN-së, etj., duket se po shkon drejt ezaurimit total ose të pjesshëm. Edhe politikat 18 vjeçare me prioritet absolut për "ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë" duke krijuar kështu mundësi për rritjen ekonomike duket se nuk mund të jenë më të vetme. Ka ardhur koha të bëjmë politika më të strukturuara, të mirë adresuara e të gjera për nxitjen maksimale të rritjes ekonomike, për garantimin faktorial të qëndrueshmërisë së saj.

Rritja ekonomike për një vend si Shqipëria mund të nxitet në tre mënyra: nëpërmjet borxheve dhe kredive nga jashtë; nëpërmjet eksporteve të lëndëve të para dhe disa produkteve të gatshme; nëpërmjet ristrukturimit ekonomik, diversifikimit të produkteve dhe adoptimit masiv të teknologjive të reja. Dy mënyrat e para gjykohet se janë më të lartë risku dhe jo shumë të qëndrueshme" në raport me të tretën. Ta mbështesësh rritjen pothuajse vetëm tek investimet apo kreditë e huaja, gjë që ne na pëlqen ta përmendim shpesh si "kulmin e suksesit të çdo qeverie" do të thotë të ushqesh iluzionin e një jetese dhe zhvillimi përtej mundësive të tua konkrete, do të thotë të jesh i varur shumë nga flukset, "devijimet" dhe "*kapricot*" e shpeshta të tregjeve financiare ndërkombëtare, do të thotë të prodhosh një rritje ekonomike jo shumë reale të mbështetur në monedha të fuqishme e të mbivlerësuara të cilat sintetizojnë një strukturë ekonomike e konsumi larg realitetit tonë. Edhe rritja ekonomike e bazuar ekskluzivisht tek lëndët e para dhe eksporti i tyre apo "eksporti i punës" kur është fjala për sektorin me fason vlerësohet si jo e qëndrueshme në periudha afat-mesme, sidomos për shkak të fluaktuacioneve të mëdha të çmimeve të tyre në tregjet ndërkombëtare. Kriza e tanishme që preku rëndë sektorin e industrisë minerare, eksportet me fason, etj., është një dëshmi më shumë e këtij konkluzioni. Ndërkohë, mënyra e tretë, që sipas shumë shembujve pozitivë në mjaft vende të botës, ka prodhuar një rritje konstante afat-gjatë është "promovimi i produkteve të përpunuara dhe ofrimi i shërbimeve moderne". Duke parë zgjerimin e tregjeve ndërkombëtare dhe kërkesës për produkte të përpunuara si dhe efektet pozitive që ato japin në rritjen e punësimit të brendshëm, nga shumë qendra e institucione të specializuara duhet që vendet si Shqipëria të bëjnë politika specifike rritjeje ekonomike me këtë fokus.

Duke qenë se ne duam të nxisim rritjen ekonomike afatgjatë duhet të mos mbetemi vetëm tek "*politikat fondamentale*" të programeve të axhustimeve strukturore si p.sh., stabiliteti makroekonomik, thellimi i privatizimeve, hapja e liberalizimi ekonomik, por të fokusohemi maksimalisht drejt politikave prodhuese e sidomos politikave energjetike, industriale dhe agrare, të jemi të kujdesshëm me stabilitetin financiar, të jemi maksimalisht të prirur për futjen masive të teknologjive të reja në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe biznesit tonë, të kemi realisht në fokus zgjerimin e kapitalit

human dhe përfshirjen sa më të gjerë të popullsisë aktive e territorit në "kontributin dhe përfitimet nga rritja ekonomike. Rritja ekonomike që ekziston në një terren ekonomiko-financiar të dominuar nga defiçiti i bilancit të pagesave, defiçiti shumë i konsiderueshëm tregtar, treg ushqimor i varur dukshëm nga importet, nxitja subjektive e kërkesës së brendshme, mospërfshirja e gjerë e grupeve të ndryshme sociale dhe tërësisë territoriale në kontributin e përfitimet nga rritja, etj., nuk vlerësohet si rritje ekonomike e qëndrueshme dhe efiçente.

Kolona vertebrale e këtij ndryshimi duhet të jetë biznesi privat, ristrukturimi dhe modernizimi i tij. Por, ky objektiv duket shumë larg arritjes së tij po të kemi parasysh gjendjen aktuale të tij. Është e vërtetë që ne kemi bërë e vazhdojmë të bëjmë shumë politika favorizuese "për përmirësimin e klimës së biznesit" apo "lehtësimin e presionit fiskal ndaj tij", por vetëm kaq duket se nuk mjafton. Ajo që është shqetësuese është "cilësia" e këtij biznesi, është brishtësia dhe në mjaft raste "amatorizmi" i tij. Mjafton t'i referohemi disa prej indekseve më të rëndësishëm ndërkombëtarë për ta sintetizuar këtë tablo. Kështu për shembull, sipas "Indeksit të konkurrueshmërisë globale 2009" që publikohet nga Forumi Ekonomik Botëror kur është fjala për "shpenzimet për kërkim-zhvillim nga ana e biznesit" jemi renditur të 126 nga 133 vende të marra në studim. Po kaq problematike duhet gjendja edhe po t'i referohemi treguesit tjetër të "sofistikimit të biznesit", tregues që krijon garancinë për zhvillim apo shpreh dobësitë e bizneseve në një vend. Jemi në vend të fundit në botë në treguesin "bashkëpunimi biznese-universitete", ndërkohë që në elementin "zhvillimi i klasterave" rezultojmë të 130, tek "sasia dhe cilësia e ofertës lokale", pra e prodhimit të brendshëm për të cilin flasim kaq shumë se duhet ta mbështesim me politika e masa konkrete, rezultojmë në vend të 110 dhe 116. Këtu mund të shtojmë dhe elementin e "përshtatjes me teknologjitë e reja" në të cilin jemi në vend të 105-të. Në këtë sens shkon dhe publikimi i fundit nga ana e Bankës Botërore i indeksit mbi ekonominë e dijes. Jemi klasifikuar në vendin e 93 nga 135 vende të botës duke rezultuar mbrapa Paraguait, Kubës, Ishujve Fixhi, Mongolisë, Xhamajkës, etj., si dhe të fundit në Ballkan larg Serbisë që është e 53, Maqedonisë që është e 58-ta. Është e qartë se edhe ky indeks i rëndësishëm na evidenton edhe njëherë situatën shqetësuese të cilësisë së ekonomisë shqiptare dhe dobësive strukturore të faktorëve të rritjes ekonomike.

"Post-tranzicioni": rruga për konsolidimin e kapitalizmit "shqiptar"

Në debatet aktuale politike apo ekonomike ka filluar të flitet e debatohet shumë për "*përfundimin e periudhës së tranzicionit në Shqipëri*" dhe fillimin e një situate specifike «*post-tranzicion*» ku fillin udhërrëfyes e luan padyshim procesi i integrimit evropian dhe domosdoshmëria e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Shqipëria po kalon nga një fazë e politikave të «*axhustimit strukturor*» të filluar në 1992, nën "*survejimin*" dhe

bashkëpunimin me FMN dhe Bankën Botërore, të cilat synonin në mënyrë prioritare stabilitetin makroekonomik të shprehur përgjithësisht në reduktimin e deficitit buxhetor, kontrollin e inflacionit, zvogëlimin e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, stabilizimin e rritjes ekonomike, thellimin e privatizimeve, hapjen e tregut dhe ekonomisë, dhe në mënyrë të veçantë krijimin e tregut të lirë, në një fazë të re. Në këto 3-4 vitet e fundit kemi hyrë në një periudhë të re politikash ekonomike të cilat synojnë reforma dhe transformime të rëndësishme strukturore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin në ekonominë evropiane dhe ndërkombëtare. Dhe e gjitha kjo në një kontekst intensiv të adaptimit me normat dhe standardet e "*acquis communitaires*" si dhe fillimin e procesit të adaptimit me kriteret e Maastricht-it, të cilat janë dhe objektivi final i strategjive dhe politikave tona të zhvillimit ekonomik e social në periudha afat-mesme dhe afat-gjata.

Por, të hysh në Evropë, në radhë të parë do të thotë të kesh koncepte të qarta dhe të ndërtosh e konsolidosh një sistem të plotë ekonomiko-social kapitalist. A e kemi shtruar ndonjëherë pyetjen, dhe aq më pak kemi tentuar të bëjmë ndonjë analizë cilësore për t'u përgjigjur me politika konkrete pyetjeve apo me saktë pikëpyetjeve të mëposhtme: cili është modeli më i përshtatshëm i kapitalizmit për Shqipërinë? ...A po ndërtojmë një model koherent e të strukturuar apo po ndërtojmë një mozaik elementesh të kapitalizmit, «*portretin shqiptar*» të të cilit nuk e di dhe nuk e ka "*projektuar*" akoma askush në një vizion afat-gjatë? Reagimi më i pritshëm është një përgjigje e tipit: «përderisa objektivi jonë final është Bashkimi Evropian, atëherë dhe modeli jonë i kapitalizmit do të jetë «*Modeli kapitalist evropian*». Po pikërisht këtu fillon dhe problemi. Kapitalizmi ka disa parime e rregulla bazë që përbëjnë thelbin e tij, por nga ana tjetër çdo vend e profilizon kapitalizmin sipas specifikave e zgjedhjes së tij. Franca ka zgjedhur modelin e «*kapitalizmit shtetëror*», Gjermania dhe vendet nordike «*kapitalizmin social-demokrat*», Anglia «*kapitalizmin liberal anglo-sakson*», etj.

Në këtë kënd-vështrim duhet që ekspertët apo politikanët, të mos e reduktojnë çdo debat, analizë apo propozim vetëm te elemente të veçanta të sistemit si p.sh. te tregu, liria e individit, avantazhet krahasuese, politikat sociale, roli dhe prezenca e shtetit në ekonomi, sistemi i tatimeve dhe taksave, sistemi i sigurimeve shoqërore dhe pensioneve, etj., por ta trajtojnë në tërësinë e tij modelin kapitalist që duhet të ndërtojmë në Shqipëri. Kjo bëhet e rëndësishme për faktin se në një masë të konsiderueshme, ne kemi ndërtuar tashme «*ekonominë e tregut*», por sapo kemi filluar të ndërtojmë kapitalizmin dhe të profilizojmë «*modelin*» e tij. Dhe ky model, nuk fillon e mbaron vetëm te tregu dhe liria individuale, por ai ka nevojë të gjykohet e kristalizohet duke marrë në konsideratë ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve specifike, forcimin e demokracisë dhe legjitimitetit të gjithë aktoreve të zhvillimit, kompromiset e nevojshme politike si dhe faktorët psikologjikë e kujtesën historike të çdo vendi. Pikërisht këto elemente ka parasysh një nga ekonomistët e njohur sot në botë për analizat e tij në raport me modelet e kapitalizmit, Magnin kur evidenton faktin se "*analiza e trajektores*

së tranzicionit të vendeve ish-komuniste të Evropës Qendrore e Lindore, tashmë anëtare të BE-se, dëshmon për lindjen e një forme origjinale të kapitalizmit, e një modeli shumë të përshtatur me historinë dhe realitetin ekonomik, social, politik e psikologjik të tyre".

Përpara se ti referohemi vetëm dhe ekskluzivisht një elementi të modelit apo një shkolle si p.sh: asaj «*ultraliberale*», "*regulacioniste*", "*institucionaliste*",etj., të preferojmë më shumë kënd-vështrimin tërësor, analizën krahasuese historike dhe gjeografike, si dhe eksperiencën e problematikën e vendeve të tjera të Evropës Qendrore e Lindore që tashmë janë integruar në BE. Sipas studiuesit holandez të modeleve të kapitalizmit, H. Uterwedde "*Është thjesht iluzion praktika e "importimit" të një modeli të gatshëm dhe ajo e krijimit të një mozaiku me anët më të mira të modeleve të ndryshme. Vetëm duke i kuptuar në tërësinë e tyre dhe respektuar kompleksitetin e çdo modeli të kapitalizmit që ekziston tashmë në botë, me të mirat dhe të këqijat e tij, mund të nxirren përfitimet e duhura nga eksperienca e të tjerëve*".

Tre konceptime evropiane për lirinë – tre modele kapitalizmi

Sipas J.Delors: "*kulturat kombëtare dhe historia specifike e çdo vendi është kundërshtari kryesor i një modeli kapitalist të përbashkët evropian*". Modelet e kapitalizmit në integritetin dhe koherencën e tyre e kanë origjinën në konceptet dhe historitë e tyre nacionale në raport me lirinë.

Përcaktimi i parë për lirinë është anglez: "*është i lirë ai që nuk i përket asnjë personi*". Dhe marrëdhëniet e biznesit dhe mënyrat e funksionimit të tregut të punës, si një nga figurat më esenciale të kapitalizmit anglez apo anglo-sakson, është simboli esencial i kësaj lirie sepse i lejon gjithkujt të ndryshojë në çdo moment punën e tij apo të hapi një biznes të ri në liri të plotë. Thelbi i kësaj filozofie është "*n.q.s. ti nuk ke sukses, përgjegjësia kryesore qëndron te aftësitë dhe përpjekjet e tua për të arritur suksesë*". Në Angli, modeli i kapitalizmit është i barabartë me "*lirinë e gjithsecilit për të hapur, zhvilluar, ndryshuar apo dhe mbyllur biznesin e tij si dhe politikat e punësimit të plotë*" të perfeksionuara dhe efektive në rezultatet e tyre nga Margaret Thatcher dhe Tony Blair-i.

Figura e dytë është liria sipas konceptit gjerman e skandinav: një njeri është i lirë "*kur dëgjohet nga komuniteti dhe e respekton mendimin e komunitetit"... "n.q.s. ti nuk ke sukses, do të thotë se kjo është dhe përgjegjësi e komunitetit që duhet të ndihmojë individin*". Në emër të parimit të solidaritetit me të tjerët krijohen një tërësi rregullash e detyrimesh që duhen zbatuar nga i gjithë sistemi ekonomik, institucional e social: ky është profili "*social-demokrat*" i kapitalizmit që krijuan gjermanët dhe skandinavët.

Portreti i tretë i kapitalizmit është ai francez. Koncepti i francezeve për lirinë është ndryshe nga dy të parët: revolucioni francez i vitit 1893 me konceptin e tij të barazisë republikane dhe "*citoyenneté*" përpunoi konceptin "*të gjithë të barabartë përballë shtetit (republikës) e cila është përgjegjëse për garantimin e kësaj barazie*". Si pasojë e këtij

koncepti për lirinë dhe domosdoshmërinë e garantimit të saj nga Republika, francezët krijuan modelin e tyre institucional të zhvillimit dhe kapitalizmit atë që sot cilësohet si "*kapitalizmi shtetëror*". Pa u zgjatur në këtë "*lojë*" përcaktimesh e përkufizimesh, është shumë e nevojshme të insistohet në faktin se një model socio-ekonomik përbëhet nga shumë elemente dhe grupon në tërësinë e tij shumë karakteristika. Ato janë: (a) karakteristika të tipit ekonomik të tilla si: mënyra e ndërtimit dhe funksionimit të tregjeve, tipet e konkurrencës, roli dhe funksionimi i ndërmarrjeve, etj.; (b) të tipit social të tilla si: praktikat dhe marrëdhëniet sociale, roli dhe mënyra e funksionimit të marrëveshjeve sociale, vendi dhe kapaciteti influencues i shoqërisë civile, etj.; (c) të tipit politik: filozofia e qeverisjes dhe organizimi i shtetit, vendi i politikës në jetën e përditshme dhe administrimin e shtetit, kultura politika, kultura e dialogut dhe kompromisit politik, etj.

Parë nën këtë kënd-vështrim, çështja e zgjedhjes dhe përcaktimit të modelit të kapitalizmit paraqitet si një fenomen shumë-dimensional, sepse funksionimi i një ekonomie mbështetet mbi shumë institucione e rregulla, mbi praktika e kompromise sociale e politike, mbi vlera historike, sociale e politike, pra mbi elemente e faktorë të konsoliduar jo vetëm ekonomike por edhe politike e sociale të një vendi. E gjitha kjo, dhe historia e ka vërtetuar tashme këtë, të çon në një konstatim shumë të rëndësishëm: se nuk ka asnjë model unik e global të kapitalizmit, por ka variante apo lloje nacionale e rajonale të kapitalizmit. Çdo shtet apo grupim shtetesh ka zhvilluar mënyrat e tij të funksionimit të ekonomisë, institucionet e tij, kompromiset e caktuara historike e politike me performancat dhe dobësitë e tyre, etj.

Në këtë kuadër, sot në botë identifikohen tre grupime të mëdha në lidhje me llojet e kapitalizmit: (a) kapitalizmi financiar & tregtar ose i quajturi "*kapitalizmi anglo-sakson*" që mishërohet në eksperiencën amerikane, britanike, Australisë, Zelandës së re, etj.; kapitalizmi i negociuar ose i quajturi "*kapitalizmi rhenan*" i tipit social-demokrat që përmbledh eksperiencën gjermane, austriake, suedeze, finlandeze, norvegjeze, daneze, japoneze, etj., dhe kapitalizmi shtetëror i përfaqësuar si variant dominues në praktikën franceze. Këtij elementi thelbësor historik e tradicional në profilizimin e modeleve të kapitalizmit aktualisht i shtohet dhe një dinamikë ndryshimesh e përshtatjesh së tyre në raport me efektet dhe pasojat e fenomenit të globalizimit. Në këtë fillim shekulli të XXI-të, debatet mbi llojet e kapitalizmit në Europë, reflektojnë një përpjekje për të harmonizuar sa më mirë "*formatimin e një modeli dominues evropian*" i cili do të jetë i aftë që të reflektojë sa më mirë aspiratat dhe traditat evropiane dhe njëkohësisht do të jetë i aftë t'i japë Evropës dinamikën e duhur të zhvillimit ekonomik e social dhe përballimit të konkurrencës së ashpër të vendeve të tilla si Kina, Brazili, India, Japonia, SHBA, etj.

Po Shqipëria, cilin model duhet të adoptojë?

Shqetësimi kryesor në politikat ekonomiko-sociale që ndërmerren në Shqipëri qëndron në koherencën dhe konsistencën e tyre në raport me një model të zgjedhur. Të gjithë jemi dëshmitarë të faktit se në shumë raste vendimmarrësit shtetërorë apo politikë "*entuziazmohen*" dhe sugjerojnë si zgjidhje shpëtimtare eksperiencat e vendeve që vizitojnë apo sugjerimet e ekspertëve të ndryshëm kombëtarë e ndërkombëtarë pa u thelluar sa duhet në analiza cilësore mbi koherencën e këtyre "formulave" në realitetin dhe modelin tonë.

Vlerësohet si shumë pozitive eksperienca amerikane në tregjet e kapitaleve dhe menjëherë kërkohet që të bëhen politika të ngjashme; emocionohen nga politikat sociale gjermane dhe menjëherë sugjerohet apo ngarkohen institucionet përkatëse që të përgatisin politika të ngjashme; njihen p.sh. eksperiencat e Hungarisë, Kilit, Hong-Kongut, etj., në tërheqjen e kapitaleve te huaja, dhe hop, menjëherë kërkohet që të zbatohen të njëjtat gjëra dhe në Shqipëri për të tërhequr sa më shumë investime të huaja pa e lidhur këtë me gjithë kontekstin ligjor e institucional të këtyre vendeve në raport me tonin; jep rezultate pozitive një politike e caktuar agro-ushqimore në BE dhe menjëherë nxitojmë ta sugjerojmë atë si shpëtimtare për bujqësinë dhe agro-industrinë tonë pa u thelluar në mënyrat e financimit apo institucionet e nevojshme për ta zbatuar atë; na duket shumë efektiv modeli i mbrojtjes sociale apo i pensioneve në vendet nordike dhe menjëherë kërkojmë ta zbatojmë atë pa e parë të lidhur ngushtë me nivelin e taksave dhe kontributeve që aplikojnë këto vende; entuziazmohemi natyrshëm nga përvojat pozitive të shtetit të vogël dhe qeverisë me përmasa të reduktuara por nuk shkojmë më tej në faktin se këto raste shoqërohen me thellim të madh të decentralizimit dhe shpërndarje të theksuar të kompetencave në nivel lokal si dhe krijimin e agjencive të specializuara që "*zëvendësojnë në mënyrë efektive*" rolin e shtetit dhe qeverisë në ofrimin e shërbimeve, etj., etj. Akoma më problematike paraqitet tabloja, kur drejtues apo ekspertë të ekonomisë pjesët e modeleve të zhvillimit përpiqen t'i bashkojnë në mënyrë voluntariste duke dashur të "arnojnë" aspekte delikate të një modeli me politika apo programe të një modeli tjetër pa një logjikë ekonomike e financiare konsistente duke prodhuar kështu "*modele hibride*" me efekte negative afat-gjata.

Një problem shqetësues në këtë këndvështrim janë dhe përmbajtja e programeve të lëndëve në Universitetet tona, kryesisht ato që kanë të bëjnë me ekonominë dhe financat. Shumë prej tyre, më tepër njësohen e identifikohen me formimin shkencor të pedagogëve që i zhvillojnë se sa janë koherente me modele të konsoliduara ekonomiko-sociale bashkëkohore. P.sh., si pasojë e faktit që pedagogu, i makroekonomisë ka studiuar në një vend anglo-sakson apo katedër universitare me preferenca liberale, studentit i mësohet se tregu është i gjithë-pushtetshëm, se ndërhyrja e shtetit në ekonomi duhet

të jetë sa më minimale, etj.; por pedagogu i mikroekonomisë ka studiuar në një katedër tjetër që është e orientuar në rrymën regulacioniste e intervencioniste dhe për pasojë studentit i mësohet se shteti duhet të jetë prezent në ekonomi, se ai duhet të bëjë politika mbështetëse, etj. Një tjetër preferon shkollën institucionaliste dhe i jep prioritet faktit se institucionet dhe cilësia e funksionimit të tyre është çelësi i suksesit, se raportet liri-individuale/institucion përcaktohen nga performanca e këtij të fundit, se shteti apo tregu janë edhe ata institucione si shumë të tjerë në një shoqëri moderne e për pasojë duhen parë në një sistem unik e tërësor,etj., dhe së fundi, kur vjen radha e lëndëve që trajtojnë politikat e zhvillimit, dikush insiston në teorinë klasike të avantazheve krahasuese dhe efektit të tregut për alokimin e burimeve, ndërkohë që dikush tjetër, më i afërt me problematikën e globalizimit e shpjegon faktin se sot avantazhet krahasuese krijohen me politika specifike e konkrete në varësi të koncepteve të reja të ndarjes së punës në shkallë botërore, rajonit ku bën pjesë, shkallës së hapjes apo integrimit të çdo vendi, zgjedhjeve strategjike apo kapaciteteve njerëzore,etj.

Në këtë këndvështrim, ka ardhur koha që kjo çështje t'i nënshtrohet një diskutimi të gjerë publik, akademik e politik, ashtu siç është absolutisht emergjente që të gjejmë një konsensus bindës afat-gjatë mbi llojin apo tiparet fondamentale të "kapitalizmit shqiptar", tipare që në kuadrin e një konsensusi të qëndrueshëm politik mbi to, duhet vazhdimisht të ndërtohen e plotësohen me kujdes me politikat tona ekonomiko-financiare e sociale te zhvillimit. Natyrisht, nuk mund të kopjojmë 100% një nga modelet e trajtuara më sipër, por nga ana tjetër, duhet t'i kushtojmë vëmendje debateve, sintezës dhe propozimeve mbi një lloj të ri kapitalizmi që po identifikohet si "kapitalizmi mesdhetar" që po konsolidohet në Itali, Greqi, Turqi, Liban, Marok, Tunizi, etj. Thelbi i tejduket se është "përputhja sa më e mirë e traditave historike e mentalitetit kombëtar me format dhe modelet e zhvillimit", "zhvillimi i biznesit të vogël dhe atij të mesëm", "krijimi i hapësirave maksimale për sipërmarrjen individuale dhe iniciativën e vogël private", "reduktimin e rolit të Shtetit në ekonomi" dhe "qeverinë e vogël", "garantimin dhe transparencën e pronës dhe funksionimit të tregjeve", "integrimin rajonal" në strategjitë e zhvillimit dhe krijimit të një ekonomie rajonale komplementare, "zhvillimin e tregjeve financiare" në mënyrë që të arrihet një ekuilibër në financimin e sipërmarrjes ndërmjet kredisë bankare dhe tregjeve të kapitalit, zhvillimi i një "proteksionizmi të moderuar" për të krijuar dhe mbrojtur tregjet e vogla lokale nga konkurrenca ndërkombëtare, "garantimin e disa kushteve speciale të zhvillimit për disa sektorë lokomotivë" për sa i përket ndikimit të tyre në PBB dhe punësim, "pranimin e një zhvillimi me dy shpejtësi" që nënkupton zhvillimin e aktiviteteve prodhuese e shërbimeve me fokus kryesor tregjet lokale apo të brendshme dhe aktivitete të orientuara drejt eksportit, ridimensionimi dhe ristrukturimi i angazhimeve politike e shtetërore në funksion të mundësive reale të ekonomisë shqiptare, etj.